

SHABAN SINANI

**PREJ SHEKULLIT TË ILUMINIZMIT GJUHËSOR
NË SHEKULLIN E NACIONALIZMIT GJUHËSOR***

**(Disa të dhëna të reja për një riperiodizim
të historisë së letërsisë shqipe)****

Atdheu im, që është dhe atdheu juaj ...

(Nga një letër e imzot Vinçens Zmajevičit drejtuar *Papa Clemente XI*)

I.

Shekulli XVIII nisi me një ngjarje historike-epokale për shqiptarët: pikërisht në vitin 1700, për herë të parë qysh prej fillimeve të Krishterimit, në krye të *Selisë së Shenjtë* u zgjodh një Papë me origjinë shqiptare: Giovanni Francesco Albani, i njohur gjerësisht si *Papa Clemente XI*, i cili apostulloi kishën romane për plot 21 vjet.

Papa Clemente XI, jo vetëm që ishte krenar për prejardhjen e tij arbërore, por, përgjatë gati një gjysmë shekulli, qysh prej se u shugurua kardinal (1690), gjatë *Pontifikatit* (1700-1721) dhe për shumë dekada pasi u nda nga jeta, me nismat e tij historikisht të pazëvendësueshme, ndikoi në shekullin e riidentifikimit të bashkëkombësve të tij.

Nëse shekulli XVIII, ndryshe prej përfytyrimit tradicional, tashmë provohet se jo vetëm nuk qe *shekull krize dhe heshetjeje*, por një kapërcyell historik prej përhumbjes në rehatinë e përkohshme të elitave otomane drejt ideologjisë shqiptare, që qysh prej imzot Giorgio Guzzetta-s do të quhej *l'albanesità*¹, kjo është e lidhur ngushtësisht me emrin dhe apostullimin e

* Një paraqitje e parë dhe e shkurtër e këtij studimi është bërë në konferencën shkencore ndërkombëtare *Urat kulturore mes Himarës dhe botës arbërore në shek. XVII-XVIII*, organizuar nga Universiteti i Vlorës *Ismail Qemali* më 10-11 nëntor 2015, në bashkautorësi me dr. Alta Haluci.

** Më herët këtë çështje e kemi shtruar në dy studime: *Jeronim de Rada dhe një çështje e riperiodizimit të historisë së letërsisë shqipe*, në “Jeronim de Rada, me rastin e 200-vjetorit të lindjes”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2015, f. 115-153; si dhe në “Çështje të riperiodizimit të historisë së letërsisë shqipe”, në “Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura”, botimet “Naimi”, Tiranë, 2015, f. 180-213.

¹ M. Mandalà, *Ideologjia albaniste dhe rilindja e parë: aktivitetet e arbëreshëve gjatë shekullit XVIII*, në “Një rilindje para Rilindjes”, botim i Universitetit “Eqrem Çabej”,

Papa Clemente XI dhe nismat e tij historike në dobi të shqiptarëve si bashkëkombës e si të krishterë².

Doktor i shkencave në *dy të drejtat*, në të drejtën kanonike kishtare dhe në të drejtën laike; sekretar i korrespondencës pontifikale në bazilikën e Shën Pjetrit; bashkëthemelues i *Accademia dell'Arcadia* (i Akademisë së Arkadisë); *Papa Clemente XI*, me autoritetin e tij vetjak, ndikoi për ndryshime pozitive të qëndrimit të Selisë së Shenjtë ndaj vendit të origjinës, *Dheut të Arbërit*.

Jashtë këtyre nismave nuk mund të kuptohet as misioni i bazilianëve në Shqipërinë e Jugut dhe ca më pak roli i klerikëve të lartë arbëreshë në ringritjen e kishës së krishterë shqiptare që nga Durrësi në Himarë në vijë bregdetare dhe që nga Adriatiku në thellësi të hinterlandit, në Ohër, ku, në selinë e dikurshme të Patrikanës së *Epirus Nova-s*, shuar në gjysmën e parë të shek. XVIII, në vendin e patrikut ishte arkipeshkop i mitruar pikërisht Basilio Matranga (1726-1748), arbëresh nga Piana degli Albanesi.



Deri më sot emri i *Papa Clemente XI*, që gjithnjë e mbiqante me krenari veten *Albani* dhe që gjatë gjithë periudhës së pontifikimit mbajti në krahun e djathtë bustin e një shenji themelues të kishës së Lindjes, të Shën Gjon Gojartit (*San Giovanni Crisostomo*), njëri prej *katër etërve të mëdhenj* të kishës së Konstantinisë, njihet kryesisht për rolin vetjak³ për organizimin e *Koncilit të Arbënit*, i njohur më gjerësisht si *Concili provintiaali o Cuvendi j Arbenit* (1703)⁴, mbajtur në kishën e Shën Gjon Kryepremitt në

Gjirokastër, 2014, f. 7-23; gjithashtu O. C. Mandalari, *Girolamo De Rada, precursore della nuova Albania*, në "Archivio Storografico dei Reduci di Guerra", Roma, 1939.

² Për vëmendjen e jashtëzakonshme që i kushtoi vendit të origjinës *Papa Clemente XI* kanë shkruar gjerësisht G. Cucco (a cura di), *Papa Albani - Le arti a Urbino e a Roma 1700-1721*, ediz. "Marsilio", Venezia, 2001 dhe N. M. Frieri, *Il dolente pontificato di Clemente XI (1700-1721)*, ediz. "Sapere Aude", Urbino, 1993. Gjithashtu: E. Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI - Albani dhe Kuvendi i Arbënit*, ndërmarrja botuese "Gjon Buzuku", Prishtinë, 1998.

³ Editorial në *Radio Vatikani*, emisioni shqip, 14 janar 2013.

⁴ B. Demiraj, *Concili provintiaali o Cuvendi j Arbenit*, shtypur nga "Botime françeskanë", Shkodër, 2012.

Mërqi të Lezhës, aktet e të cilit iu kushtuan pikërisht atij, *Papës Albani, Klementit të njëmbëdhjetë pretëmadhit*⁵.

Këtu nuk është vendi të ndalemi gjatë në meritat e *Papa Clemente XI* për rivendosjen e një rendi sufraganiteti disiplinues midis autoriteteve kishtare ndër arbërit e atij shekulli. Por pandashmërisht prej kësaj iniciative janë së paku dhe tri merita të tjera: **1.** *Fjalori italisht shqip* i Francesco Maria da Lecce-s⁶, misionar jezuit i pranishëm në këtë koncil dhe ndoshta dhe mbajtësi i procesverbalit të tij; **2.** Një gramatikë e shqipes prej të njëjtit autor⁷; **3.** Dhe mbi të gjitha kapërcimi prej arkeonimeve *epirot, maqedonas e arbënor* tek etnonimi i ri, *shqiptar e Shqipëri*.

Francesco Maria da Lecce e pohon shprehimisht në parathënien e gramatikës së tij se kjo vepër iu botua nën *Pontifikatin e lavdishëm të Papa Clemente XI, lumturisht në krye të kishës katolike: e publicate sotto il glorioso Ponteficato di Clemente XI, felicemente Regnante*⁸.

Me të drejtë aktet e *Koncilit të Arbënit* janë përmendur rregullisht si e fundmja vepër e letërsisë më të vjetër, pas së cilës në mënyrë të natyrshme nis një proces i ri identifikimi. Rilindja Kombëtare shqiptare e shek. XIX pati luksin t'i gjente të gatshme, jo vetëm mitet themelore të romantizmit: mitin e gjuhës amtare, mitin e lashtësisë dhe të prejardhjes fisnike, mitin e autoktonisë, mitin e motit të madh të rezistencës antiosmane, mitin e

⁵ Aktet e këtij kuvendi, që pati si qëllim themelor ringritjen e kishës së krishterë në Shqipëri, njihen me emrin *Concilli i dheut Scicypniis, baamun n'vjet 1703 n'coh t'Paps scchyptarit Clementitt t'gnimdheitt*.

⁶ F. M. da Lecce, *Dittionario italiano-albanese, 1702*, botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip, përg. Gëzim Gurga, "Botimet françeskane", Shkodër, 2009.

⁷ *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese, del padre Francesco Maria da Lecce*, Roma 1716, con licenza de superiori, nella "Stamperia della Seg. Cong. di Prop. Fede".

⁸ F. M. da Lecce, *Osservazioni Grammaticali Nella Lingua Albanese*, ediz. Sag. Congr. di Prop. Fede., Roma 1716, p. III-IV: *Quindi é, che volendo io in parte sodisfare a miei alti debiti, contratti già con l'EE. VV., e non sapendo al mio ritorno in Italia, doppo il corso d'anni venti consumati in Sacre Missioni, come buttarmi à piedi di cotesta Sag. Congregazione, pensai d'imitare la continuata pietà, e Clemenza dell'EE.VV. medesime verso gl'Alumni di Propag. Fede, à beneficio de quali formai le presenti Osservazioni Grammaticali nella Lingua Albanese, le quali con umile, e divoto ossequio consagro, in perpetuo attestato de miei doveri, al merito sublime dell'EE.VV., e spero, che sotto l'Ombra di Personaggi sì eccelsi, & al riflesso di sì gran luce riceveranno quella stima, che per se stesse non meritano: concorrendo ancora ad'ingrandirle, l'essergli toccato in sorte, d'esser date alla luce, e publicate sotto il glorioso Ponteficato di Clemente XI, felicemente Regnante, sotto di qualunque Opra per picciola, che sia, perchè abbia per scopo, & in Idea la propagazione della vera Romana Religione, cresce di stima, & dismisura s'ingrandisce.*

projekti për botimin e një kolane që do të dëshmonte historinë kishtare të ilirëve, njohur me titullin *Illyricum Sacrum*, që nisi të shtypej duke filluar prej mesit të shekullit XVIII, ka qenë një ide e hershme e *Papa Clemente XI*. Prospekti i kësaj kolane, nga më të rëndësishmet në gjithë historinë e popullit shqiptar, u përfundua më 1718 nga Filippo Riceputi, që, ashtu si Francesco Maria da Lecce, i takonte urdhërit jezuit. Më 1719 Riceputi u thirr në Romë të thellonte kërkimet e tij në arkivat e Vatikanit. *Papa Clemente XI* e priti Riceputin në një audiencë të posaçme (*audientiae*), gjatë së cilës iu dorëzua personalisht dhe i përfunduar prospekti i *Illyricum Sacrum*, i njohur shkencërisht me titullin *Prospectus Illyrici Sacri, cuius historiam describendam typisque mandandam suscipit* (Patavii 1720)¹⁰.

Prospekti u shtyp më 1720 drejtpërsëdrejti me ndihmën financiare personale të *Papa Clemente XI*, i cili tregoi vëmendje të vijueshme ndaj tij. Veç të tjerash, Riceputi fitoi *privilegjin apostolik papnor* (*Privilegium Apostolicum*) për të bërë kërkime në të gjitha arkivat kishtarë, liri që vetëm Ati i Shenjtë mund ta lejonte¹¹. Privilegji papnor përfshinte edhe lejen për të këshilluar arkiva sekrete dhe tepër sekrete¹². Teksti i rekomandimit të *Papa Clemente XI* mban datën 30 prill 1720 dhe është botuar disa herë prej disa studiuesve¹³. Kjo leje iu validua menjëherë dhe pa asnjë mëdyshje, me gjithë letrat qortuese që i dërgoheshin Selisë së Shenjtë për autorin, edhe prej *Papa Innocenti-t XIII*, që pontifikoi pas *Papa Clemente XI*.

Gjatë së njëjtës audiencë (1719), F. Riceputi iu përgjigj me një raport të detajuar *shtatë porosive* të drejtpërdrejta të *Papa Clemente XI* për gjendjes kishtare në *Illyricum*-in e shek. XVIII dhe për nevojat e kishës e të klerit për ndihmën dhe ndërhyrjen e Selisë së Shenjtë. Prej një dëshmie të vitit 1737, përmes së cilës i kërkohet Riceputi-t të kthejë në Romë (*restitutum Romae*) dorëshkrimet që i ishin dhënë për të hartuar prospektin e tij, vërtetohet se *Papa Clemente XI* i kishte vënë atij në dispozicion edhe burime të dhuruara prej atij vetë: të familjes Albani e të arkivave të Vatikanit¹⁴.

¹⁰ *Prospectus Illyrici sacri cuius historiam describendam typisque mandandam suscipit P. Fil. Riceputi*, Societatis Jesu Sacerdotes, Patavii MDCCXX, excudebat Josepus Cominus, Superiorum permissu. Me këtë titull u botua si një vepër më vete më 1720, në të gjallë të *Papa Clemente XI*.

¹¹ J. Ljučić, *Daniele Farlati (1690-1773)*, në "Historijski zbornik", 1972-1972, vol. XXV-XVII, Zagreb, 1974, st. 231-232.

¹² M. Šamšalović, *Grada za Illyricum Sacrum sačuvana u Padovi*, ed. Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Dubrovnik, 1960, st. 419-431.

¹³ Shih për shembull M. Vanino, *Illyricum sacrum i Filip Riceputi*, botuar në "Croatia Sacra", vol. I, Zagreb, 1931, st. 287.

¹⁴ H. Morović, *Bilješke uz katalog Riceputijeve "Ilirske biblioteke"*, në "Vjesnik bibliotekara Hrvatske", vol. 9, Zagreb, 1963, st. 27-45.

Ndonëse botimi i *Illyricum Sacrum*, në tetë vëllime, pa llogaritur të nëntin, *Erratum et corrigendum*, me saktësime e ndreqje ndaj punës së paraardhësve, Daniele Farlati e Jacopo Coleti, që përgatiti Franjo Bulić më 1910¹⁵, nis në vitin 1751, në tërësi koncepti, projektimi dhe realizimi i arkivit më të rëndësishëm të historisë së Shqipërisë së krishterë është meritë e *Papa Clemente XI*. Për fat të keq, gjysma tjetër e projektit të *Papës Albani*, korpusi *Illyrici prophani (Illyrici pagani)*¹⁶, që do të thellonte dëshminë e historisë protoshqiptare deri dy mijë vjet para Krishtit, mbeti e parealizuar atëherë dhe deri sot.

Titulli i plotë i gjithë korpusit prej 15 vëllimesh, sipas konceptit të F. Riceputi-t, miratuar nga Papa Clemente XI, do të ishte: *Universa sacri et prophani illyrici historia – Historia e përgjithshme e ilirëve paganë dhe të krishterë*. Vëllimi i parë i *Illyricum Sacrum* hapet me fjalinë: *Hilluri filii serpentis sunt – ilirët janë bijtë e gjarpërit*. Ndonëse përmes mitologjisë, projekti i *Papa Clementi XI* është i pari në histori, që përmend shprehimisht origjinën ilire të shqiptarëve, atëherë kur ende shkrimtarët shqiptarë më të vjetër e quanin veten *arbëneshë* dhe gjuhën e tyre *epirotishte*.

¹⁵ Titulli i plotë: *Accessiones et correctiones all'Illyricum sacrum del P.D. Farlati, manoscrito inedito pubblicato dal prof. Fr. Bulić*, Supplemento al Bullettino di archeol. e stor. daim., a. 1902-1910.

¹⁶ J. Ljučić, vep. cit., st. 233.



Imazh ikonografik i *Shën Mërisë Virgjëreshë*, trashëgimi e kishës arbëreshe të Palazzo Adriano-s, me shenjinimin *Albanensis Palatii Adriani quibus in visu apparuit* (1790).

3. Nëse përmes kongregatës jezuite *Papa Clemente XI* realizoi një qëllim shkencor të lartë, konceptimin e një historie tërësore të *Illyricum*-it përgjatë katër mijë vjetëve, në 15 vëllime, dhe realizimin e pjesshëm të tij, në 8 volume; përmes hierarkisë kishtare, në formën e një autoriteti të trashëguar, ai do t'u gjendej bashkatdhetarëve të vet në rrezik edhe pas vdekjes. Këtu është fjala për rolin që luajti arkipeshkvi i Tivarit Vincenz Zmaievich (*Vinçens Zmajeviç*, *Viçko Zmaieuiçi Perascstanina*, *Vicko Zmaieviç*, *Vincentius*

Zmaievichi), protagonist i *Kuvendit të Arbënit*, ngarkuar drejtpërsëdrejti prej autoritetit papnor për organizimin e tij, që në vitet 1731-1734 do të ishte faktor vendimtar për vendosjen e disa grupeve shqiptare të shpërngulura nga vendlindja e tyre në veriun shqiptar nën tryshinë otomane në *Zadar (Zarë) të Kroacisë*, ku themeluan ngulimin e quajtur *Arbënesh i Zarës*. Nëse formalisht merita e marrjes në mbrojtje të kësaj bashkësie shqiptare, e fundmja që u shpërngul prej vendit të tij duke marrë me vete arkeonimin *arbanas, arbënesh*, i njihet Zmaievich-it, një paraprijësi të cilit Pjetër Bogdani qysh në vitin 1685 i kishte kushtuar një vjershë në veprën e tij *Cuneus prophetarum (Zmaievich, o drita jonë*, për Andrean Zmaievich), thelbësisht prej studiuesve pranohet se ai veproi nën hijen sovrane të *Papa Albanit*, i cili vazhdonte të ishte mbrojtës i të vetëve edhe pas vdekjes¹⁷.

¹⁷ Krhs. G. Stepanić, *Hrvatsko pjesništvo na latinskom u sedamnaestom stoljeću: stilske tendencije i žanrovski inventar*, Doktorska disertacija, Zagreb, 2005, st. 92-96.



Ballina e Musarum Chorus, vepër e abatis Vincentio Zmaievich Perastinit¹⁸.

4. Nisma e katërt e Papa Clemente XI (duke llogaritur si nismë të parë thirrjen e Koncilit të Arbënit) lidhet padyshim me rolin që ai luajti për

¹⁸ Titulli i plotë: *Musarum chorus excitatus ad laudes illustriss. et excellentiss. d. d. Antonii Zeni Venetarum copiarum terra, marique iam inaugurati praefecti generalis ab abbate Vincentio Zmaievich Perastino, Collegii Urbani de Propaganda Fide alumno*. Romae, Typis Francisci de Rubeis, & Francisci Mariae Acsamitek à Kronenfeld. MDCXCIV.

inkurajimin e misionit të murgjve bazilianë në mbrojtje të bashkatdhetarëve të vet në Shqipërinë e Jugut, ku sundimi otoman ishte në ekspansion, besimi i ortodoksëve shqiptarë ndaj Kishës së Fanarit ishte dobësuar shumë dhe shpresa e tyre ndaj Perëndimit: Selisë së Shenjtë, mbretërisë së Napolit, mbretërisë së Aragonës, republikës së Shën Markut dhe perandorisë së Ekaterinës së Madhe të Petersburgut, kishte mbetur e vetmja shpresë mbijetese. Në fakt, qysh në vitin 1577, himariotët ishin betuar se do të njihnin si të vetmin apostullues të Krishterimit në tokë Atin e Shenjtë, nëse do të kishin mbrojtjen e saj nga perandoria otomane. Kjo mbështetje erdhi me mjaft vonesë. Papa Gregori XIII do t'u dërgonte atyre lutje dhe përshtirje. Në shekullin XVII do të urdhërohej për herë të parë misioni i bazilianëve. Në shekullin XVIII misionarët bazilianë do të ishin thuajse të gjithë arbëreshë. *Faza e parë misionare u mbyll me apostolatin e Arcadio Stanila-s, që ishte misionari i fundit me prejardhje joarbëreshe, shkruan Nilo Borgia. Misioni i Himarës lulëzoi për aq kohë sa iu dha mundësia murgjve italo-shqiptarë të merrnin pjesë në to*¹⁹. Kronologjikisht ky kalim cilësor, që e shndërroi misionin e bazilianëve në mision të arbëreshëve tek bashkatdhetarët e tyre, ndodhi pikërisht në kohën kur Giovanni Francesco Albani, së paku, ishte sekretar i korrespondencës papnore në bazilikën e Shën Pjetrit dhe xhaxhai i tij, Annibale Albani, ishte ndërkaq prefekt i Bibliotekës Apostolike të Vatikanit. Edhe pas vdekjes së Papa Clemente XI, kongregata e shenjtë vazhdoi të ishte e të njëjtit qëndrim, për ta ngritur misionin bazilian, që në fakt tashmë ishte një mision shqiptarësh tek shqiptarët, në po të njëjtën lartësi me paraardhësit e tij. Në vitin 1726, shkruan Nilo Borgia, mbërritën në Romë tre prijës himarjotë dhe iu lutën Selisë së Shenjtë për të fituar të njëjtën përkrahje për të cilën i kishin kërkuar mbrojtjes Papës së ndjerë Clemente XI, që madje u kishte lëshuar atyre një *rescriptum* miratues²⁰.

Ardhja e misionarëve të lartë kishtarë arbëreshë në këtë anë të Adriatikut, si kryesues të urdhërit ekumenik brazilian, që bashkonte liturgjinë lindore me vartësinë romane, si Filoteo Zassi, Basilio Matranga e Giuseppe Schirò senior, nuk mund të ndahet nga emri i Atit të Shenjtë *Papa Clemente XI*, i vetmi Papë me një lidhje të fortë arbërore-shqiptare, që ka apostulluar në kishën e Shën Pjetrit gjatë dymijë vjetëve histori të Krishterimit botëror. Gjithë lëvizja kulturore dhe ajo e mendimit shqiptar përgjatë shekullit XVIII gjendet nën ndikimin sovran të dy emrave të mëdhenj: Papa Clemente XI dhe Gottfried Leibniz.

¹⁹ N. Borgia, *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri - shënime mbi misionet në Himarë: shek. XVI-XVIII*, bot. "Naimi", Tiranë, 2014, f. 14, 21.

²⁰ *Rescritto* në origjinal: në të drejtën kanonike është vendim me shkrim i autoriteteve kishtare kompetente që i përgjigjet një lutjeje për falje apo për ndonjë përfitim tjetër.

5. Megjithëse i themeluar më 1723, dy vjet pas vdekjes së *Papa Clemente XI*, me iniciativën e Selisë së Shenjtë, prej pasuesit të tij apostullues në bazilikën e Shën Pjetrit, kolegji arbëresh *Corsini* i San Benedetto-s në Ullano, i njohur prej tyre si *Shën Benedhiti: una vera e propria struttura universitaria per la formazione del clero greco-albanese*, që në fund të atij shekulli do të qendërzohej në fshatin Shën Mitër të arbëreshëve, *San Demetrio Corone*, duke marrë emrin *kolegji i Shën Adrianos*, siç është tashmë e provuar, ishte iniciativë drejtpërsëdrejti e tij²¹. Ngritja e këtij kolegji ishte vepra themelore e *Papa Clemente XI* në dobi të arbëreshëve dhe i vuri vulën shekullit XVIII si *shekull i kolegjeve dhe i seminareve*, që do të ishin mjediset ku lindi për së pari interesimi për gjuhën shqipe dhe për origjinën e shqiptarëve si popull. Me këtë kolegji lidhet edhe emri i arbëreshit Felice Rodotà, themelues i tij dhe një prej mendimtarëve më të hershëm të ideologjisë pararilindëse, njohur më shumë si *albanesità*.

II.

Shekulli XVIII për botën shqiptare, siç u përmend, pati dhe një protagonist tjetër, dhe ky ishte filozofi e gjuhëtari gjerman Gottfried Wilhelm von Leibniz, një figurë qendrore e iluminizmit gjuhësor gjerman. Në fakt, *Papa Clemente XI* dhe Leibniz nuk ishin aspak larg njëri-tjetrit, pavarësisht se njëri ishte klerik i shuguruar në shkallën më të lartë prej konklavës së kardinalëve më 19-20 nëntor 1700, kurse tjetri mendimtar i lirë iluminist.

Papa Clemente XI i njihet botërisht merita e protektorit të bibliotekave dhe, para së gjithash, i pasuruesit të Bibliotekës Apostolike të Vatikanit. Ai ishte njeri i akademive dhe aulave universitare, i ndikuar dhe vetë prej ideve iluministe. Në anën tjetër, iluminizmi gjerman nuk qe anti-besim si ai francez. Dhe, veç të tjerash, iluminizmi i Leibniz-it ishte i lidhur me idenë e *lulëzimit të gjuhëve popullore*, që e kishte burimin qysh në shekujt e humanizmit të Renesancës Europiane, kur u ndanë në një krah *latinistët konservatorë* dhe në krahun tjetër *volgaristët liberalë*, që kërkonin lulëzimin e gjuhëve popullore²². Kjo pikëpamje e tij u shpreh qartazi e sistemuar në studimin *Desiderata circa linguas popularum – Dëshira rreth gjuhëve popullore*.

Ndër mendimtarët shqiptarë, i pari që i pati kushtuar rëndësi pikëpamjes së Leibniz-it për gjuhën shqipe, është Faik Konica, me artikullin e

²¹ Shih për këtë: F. Altimari; M. Bolognari; P. Carrozza, *L'esilio della parola: la minoranza linguistica albanese in Italia: profili storico-letterari, antropologici e giuridico-istituzionali*, Pisa, 1986.

²² Për më gjerë shih Sh. Sinani, *Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura*, bot. "Naimi", Tiranë, 2015, f. 149.

shkurtër *L'opinion de Leibnitz sur la langue albanaise* (botuar në revistën *Albania* nr. 3, viti 1897, f. 41).

Afëria e qëndrimit të *Papa Clemente XI Albanit* ndaj gjuhës shqipe me atë të filozofit gjerman Leibniz shihet qartazi në letërkëmbimin e tij me arkipeshkvin e Tivarit *Vincenzo Zmaievich* (Vinçens Zmajeviç), kur i kërkoj të bënte një vizitë pastorale në të gjitha viset e dheut të Arbënit dhe për të vërejtur gjendjen e kishës dhe të popullit të tij: *Dëshiroj të përmbushësh një vizitë pastorale në trojet e Arbërisë, të vesh atje dhe të shikosh nga afër kryepeshkvitë, ipeshkvitë, dioqezat dhe famullitë. Pasi të keni bërë këtë punë dua nga ju një raport të hollësishëm për gjendjen e kishave të Arbënisë dhe të besimtareve. Dhe më në fund dua të di a e përdor ai popull gjuhën e vet, të folmen arbëreshe*. Dhe ja përgjigjja e arkipeshkvit në mbarim të misionit: *Konstatimet e mia do të ishin të pavlera nëse s'do të ndërmerreshin hapa të menjëhershëm për t'i ardhur në ndihmë popullit të Arbërisë, që është, në të njëjtën kohë, edhe populli juaj, o Atë i Shenjtë*^{23 24}.

²³ Shih V. Zmajević, *Notitie universali dello stato di Albania e dell'operato da Monsignor Vincenzo Zmaievich, Arcivescovo di Antivari, Visitatore Apostolico dell'Albania*, në "Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert" (ed. by Peter Bartl), vol. II, Wiesbaden-Munich, 1979, p. 113. Krhs. dhe R. D. Chelaru, *Between coexistence and assimilation: Catholic identity and Islam in the Western Balkans (seventeenth-eighteenth centuries)*, në "Revista istorică", tom XXIII, nr. 3-4, București, 2012, p. 291-324. Gjithashtu: V. Babić, *Razgovor duhovni Vicka Zmajevića, HKD Napredak, Zadar, 2005*; V. Babić (prir.), *Hrvatska književnost Boke Kotorske do preporoda*, ured. "Erasmus naklada", Zagreb, 1998; K. Krstić, *Vicko Zmajević*, në "Enciklopedija Jugoslavije", JLZ, Zagreb, 1971; S. Novak (prir.), *Stara bokeljska književnost*, ured. "Matica hrvatska", Zagreb 1996; L. Čoralić, *Iz prošlosti Boke - peraški rod Zmajevića*, në "Slobodna Dalmacija", 8-10 prill 2004 (f. 3-4) dhe 13-14 prill 2004 (f. 4-5); G. Stepanić, *Hrvatsko pjesništvo na latinskom u sedamnaestom stoljeću: stilske tendencije i žanrovski inventar*, edit. "Sveučilište u Zagrebu", Zagreb, 2005, p. 92-96; T. Mrkonjić, *Vicko Zmajević*, në "Gli scritti filologici di Giovanni Pastrizio (1636-1708)", Roma, 1991, p. 532-533; B. Pavao, *Zmajevići* (ogledi), Zagreb, 1988. Rreth letërkëmbimit midis Vinçens Zmajeviçit dhe Selisë së Shenjtë më gjerësisht mund të krahasohen të dhënat e paraqitura nga Eqrem Zenelaj, në studimin e tij monografik *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë - Papës Clementi XI - Albani*, botim i shtëpisë botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2009.

²⁴ Interesimi i ndërsjellë të Papa Klementit XI dhe i arkipeshkvit të Tivarit Vinçens Zmajeviç për gjuhën e të parëve gjendet edhe në relacionin *Vincentius Zmajevic, archiepiscopus Antibarensis, rogat papam Clementem XI, ut patrum sui Andreae ecclesiasticos annales illyrica lingua exaratos publici iuris faciat* (Cathari, 1 septembris 1711). Në Augustin Theiner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam illustrantia. A Clemente VII, usque ad Pium VII (1524-1800) cum additamentis saec. XIII et XIV*, volume 2, Zeller, 1968, p. 241-243.

Me *Papa Clemente XI* filozofin gjerman Leibniz e bashkoi edhe koncepti i tij për një *kishë ekumenike*, që do të afronte e bashkonte katolikët dhe luterianët reformatorë. Nisma papnore e Selisë së Shenjtë për dërgimin e misionarëve bazilianë tek besimtarët shqiptarë të rrezikuar nga pushtimi dhe të braktisur nga kisha ishte shprehje e drejtpërdrejtë e pikëpamjes ekumenike të *Papa Albanit* dhe të papëve të tjerë, që patën marrë vendimin për themelimin dhe kanonizimin e urdhërit të bazilianëve.

Pikërisht në kohën kur Francesco Maria da Lecce hartonte fjalorin e tij italisht-shqip, Leibniz, në një letër të vitit 1709 shprehej se ishte i lumtur që kishte mësuar për ekzistencën e një libri dhe të një *fjalori të gjuhës shqipe*: *I was very pleased to hear that you have received a book and a Dictionary of the Albanian Language*²⁵. Ishte fjala për veprën *Dottrina christiana* (botimi i dytë, i vitit 1664) të Pjetër Budit dhe për *Dictionarum latino-epiroticum* të Frang Bardhit (1635)²⁶.



Vëmendja e posaçme që Leibniz i kushtoi karakterit indoeuropean të shqipes, lidhjeve të saj me ilirishten, rëndësisë së njohjes së saj për të shpjeguar zhvillime gjuhësore jo vetëm brenda, por dhe jashtë saj, është spikatur, përveçse prej albanologëve, edhe prej indoeuropeistësh të mirënjohur, si Eric P. Hamp²⁷.

²⁵ G. W. Leibniz, *Opera Philologica*, edit. "Georg Olms", Hildesheim, 1989. Këtu citohet sipas përkthimit anglisht nga Robert Elsie.

²⁶ B. Demiraj, *Si ta lexojmë Lajbnicin*, në "Studime filologjike", nr. 1-2, 2001, f. 165-166.

²⁷ E. P. Hamp, *On Leibniz's Third Albanian Letter*, në "Zeitschrift für Balkanologie", nr. 16, 1981.



Stema e *Papa Clemente XI* në një monedhë të rrallë të emetuar në dekadat e apostullimit të tij.

Misioni i murgjve të urdhërit të Shën Vasilit në viset jugore të Shqipërisë në shekullin XVIII jo rastësisht përkon me lulëzimin e Voskopojës, me themelimin e tipografisë dhe të *Akademisë së Re*, me përgatitjen e librave shkollorë dhe traktateve filozofikë e teozofikë, me hartimin e fjalorëve dhe të gramatikave, me ndriçimin iluminist të multilinguizmit dhe të bashkëjetesës ndëretnike të shqiptarëve, vllahëve dhe grekëve. Në të dy krahët, në Bregdet e në thellësi, jo rastësisht, u gjenden të njëjtët protagonistë, si arbëreshi Basilio Matranga, kryepeshkop i Ohrit dhe po ashtu kryepeshkop i Durrësit dhe vikar apostolik i Himarës.

Dorëshkrimet e ruajtura në hapësirën historike shqiptare dëshmojnë praninë e kultit të Shën Vasilit të Madh, së paku, qysh në shek. XIII sidomos në viset jugore të Shqipërisë. *Kodiku i 39-të*, i *Beratit*, shek. XIII, përmban ligjërata mbi asketizmin të këtij shenjtori me autoritet të fuqishëm tek

bashkësitë kishtare të Italisë së Jugut. Edhe vetë shkolla e shkruesve të kodikëve të Shqipërisë paraqet tipare përbashkuese me ato të rajoneve të Sicilisë dhe të Calabria-s (*Kodikët i 34-t, i Beratit*).

Disa veçanti paleografike të kodikëve të Beratit, duke përfshirë atë me numër reference 40, janë të krahasueshme me ato të kodikëve italo-jugorë²⁸. Gottfried Wilhelm Leibniz nuk ndërmori vetë udhëtime për të hetuar gjendjen e gjuhëve të panjohura popullore, por idetë e tij iluministe nxitën dijen europiane të drejtohej në këto anë e kënde të shmangura të Evropës.

Gramatikës dhe fjalorit dygjuhësh të Francesco Maria da Lecce-s; një gramatike dhe disa vjershave të Nilo Catalano-s dhe një doktrine të krishterë të hartuar shqip e greqisht prej nxënësve të Neofit Rodinò-it; u shtohen fjalorët e bisedimeve dhe gramatikat e shqipes të Teodor Kavaliotit dhe Marko Boçarit, deri tek Daniil Voskopojar. Një figurë qendrore e *shekullit të Voskopojes*, T. Kavalioti, jo vetëm i njëjtte konceptet teorike të Leibniz-it, që paraprinë gjuhësinë e krahasuar, por dhe ishte i ndikuar prej tyre, prej idesë së një origjine të përbashkët të gjuhëve, prej cilësimit të tyre si një monument i mendimit njerëzor, për rëndësinë e etimologjisë dhe të krahasimit të gjuhëve për shpjegimin e vetë prejardhjes së popujve²⁹. Interesi i shkencës europiane për gjuhën *epirote* apo *ilire*, siç quhej atëherë gjuha shqipe, gjeti përfitim (receptim) e mbështetje të menjëhershme entuziaste vullnetare tek bashkëpunëtorët vendës. Pas çdo veprë me rëndësi për albanologjinë, që u botua në atë shekull e më vonë, gjendet gjithnjë një personalitet shqiptar (George Pouqueville dhe Marko Boçari, Johann Thunmann dhe Kostë Xhehani (Çehani, Çekani) dhe Teodor Kavalioti; Johan G. von Hahn dhe Apostol Meksi; W. Xylander-i dhe Vangjel Meksi dhe të tjerë)³⁰.

Sado paradoksale që mund të ngjajë, shekulli i arsyes dhe i arsimit në botën shqiptare është i lidhur fort me misionin e murgjve bazilianë në Shqipëri, me emrin e *Papa Clemente XI* dhe jo më pak edhe me idetë

²⁸ A. Rëmbeci, *Kodikët mesjetarë në Shqipëri, ura kulturore midis Lindjes dhe Perëndimit: rasti i kodikëve me prejardhje italo-bizantine*, në “Shqipëria mes Lindjes dhe Perëndimit”, Universiteti i Tiranës, bot. “Ani-Print”, Tiranë, 2014, f. 19-41.

²⁹ N. Bardu, *Eighteenth Century Aromanian Writers: the Enlightenment and the Awakening of National and Balkan Consciousness*, në “Philologica Jassyensia”, an III, nr. 1, 2007, p. 95-96: *After completing with excellent results his humanistic studies in the native town, Cavalioti was sent by its inhabitants, who raised money for him through public subscription, to the Marutzian College of Ianina, which was dominated by the daring ideas and brilliant eloquence of a Greek scholar called Evghenie Vulgaris. Translator of Voltaire, and acquainted with the philosophy of Leibniz, Wolf and Locke, Evghenie Vulgaris had a tremendous influence on those around him.*

³⁰ Shih tek Sh. Sinani, *Kodikët kronografikë të Shqipërisë*, bot. “Naimi”, Tiranë, 2014, f. 435-437.

iluministe të Leibniz-it. Është me vend të kujtojmë se iluminizmi gjerman, ndryshe prej atij francez, nuk qe antiklerikal dhe antikishtar. Iluministët gjermanë kishin dyshimet e tyre për *Zotin klasik*, por ata asnjëherë nuk shkuan deri tek dysia përjashtuese besim-dije, Zot-shkencë.

Imzot Nilo Catalano, kryesues i misionit të bazilianëve në Himarë në vitet 1693-1694, ndonëse i huaj në origjinë, *u bë më yni se tanët*, u arbëreshizua dhe u shqiptarësua; shkroi tri poezi në gjuhën shqipe, që Niccolò Figlia i kopjoi në dorëshkrimin e njohur *Il Codice Chieutino*; hartoi një gramatikë të gjuhës së vendësve dhe e ktheu kishën e Dhërmiut në shkollë katekizmi e diturie, ku morën mësimet të krishterë e myslimanë, ortodoksë e katolikë. Giuseppe Schirò prosenior, një tjetër kryesues i këtij misioni, arbëresh prej Horës, i emëruar arkipeshkv i Durrësit dhe vikar apostolik i Himarës, e ngriti për herë të parë në funksionet e një gjuhe zyrtare, duke e përdorur atë si gjuhë primare në letërkëmbimin me Papa Benedicti-n XIV³¹. *Ai ishte i pari që e përdori shqipen në një dokument zyrtar ... në vitin 1742, me siguri për t'i dhënë përgjigje pyetjes së shtruar nga Papa Benedikti XIV apo nga grupi i ekspertëve të ngarkuar prej tij*³². Misionarët arbëreshë, që erdhën me detyra kishtarë jo vetëm në vendin e të parëve, morën vendimin që të përdornin në shkrimet e tyre alfabetin e F. Bardhit, meqë ky ishte alfabeti i librit të parë i shqipes zyrtarisht *confirmatur* prej *Propagada Fidae-s*, duke shenjuar me këtë një hap tjetër konvergjence shkrimi, gjuhe e komunikimi ndërshqiptar.

Është e vërtetë se prurjet e iluminizmit gjuhësor të shekullit XVIII qenë kryesisht fjalorë e gramatika që u drejtoheshin të huajve (italianë, grekë, bullgarë, rumunë e arumunë) për të mësuar shqipen. Por pikërisht ky shekull përgatiti epokën e letërsisë kombëtare, kur, ata që u morën me shqipen, si Thimi Mitko, patën parasysh shqipfolësin dhe si qëllim një vepër që të ndihmonte bashkatdhetarët për të zotëruar gjuhën e vet³³. Ky kapërcim, prej shekullit kur fjalorët e gramatikat, siç shkruan Francesco Maria da Lecce, ishin hartuar *jo për ty o shqipëtaar*, por për ata që nuk dinin shqip, në shekullin e romantizmit, të ideologjisë kombëtare, nuk ishte kalim prej zbrazëtisë në ringjallje. Iluminizmi gjuhësor përgatiti ideologjinë kombëtare, e cila u shfaq para së gjithash si *nacionalizëm gjuhësor*, me kultin e gjuhës

³¹ B. Demiraj, *Joseph Schirò në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*, në “Studi filologjici arbëreshë”, ediz. “Comet Editor Press”, Cosenza, 2015, p. 85-131.

³² F. Altimari, *Urat e Arbërit*, bot. “Naimi”, Tiranë, 2015, f. 126.

³³ J. Bullo, *Parathënie*, në Thimi Mitko, *Fjalëtore shqip-gërqisht gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike* (përgatitja e dorëshkrimeve për botim dhe studimi hyrës nga Dhori Q. Qiriazhi), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2014.

amtare, që kishte një traditë shumë më të hershme, që prej fillimeve të shkrimit shqip.

Në shekullin e iluminizmit gjuhësor shqipja u shtua në fjalorë bisedimesh për t'u lehtësuar shqiptarëve të mësonin greqisht ose të huajve të mësonin shqip; kurse në shekullin e nacionalizmit gjuhësor shqipja u përdor në fjalorë e gramatika për mësimin e saj si gjuhë amtare, dhe ky është një ndryshim thelbësor, por jo një përmbysje kopernikane. Konstantin Kristoforidhi dhe Thimi Mitko, Demetrio Camarda dhe Jeronim de Rada, ndoqën të njëjtat udhë bashkëpunimi me albanologët e huaj si parardhësit. Fjalorët e bisedimeve italisht-shqip-greqisht të Mitkos u hartuan duke ndjekur modelet e fjalorëve të mjeshtëreve të *Akademisë së Re* të Voskopojës, megjithëse funksionet ndryshuan përparësi.

Gjatë periudhës së iluminizmit gjuhësor u përpunua miti pellazgjik i burimit të shqipes, si çështje e dijes; për t'u kthyer më vonë në një mit romantik albanocentrist, për shqipen si *gjuhë perëndie* dhe për shqiptarët si popull që kishin qenë në këtë botë edhe kur *Adhami dhë s'kishte lerë*. Por a nuk kishte shkruar thujse të njëjtën gjë një shekull më herët shkrimtari arkipeshkëv Pjetër Bogdani, në veprën e tij *Cuneus prophetarum*, duke caktuar si datën më të hershme të përmendjes së dheut të Arbërit *vitin 2878 pas Gjenezës*, krijimit të rruzullimit sipas Biblës? Thënë qartazi, qysh në shekullin XVIII shqiptarët filluan ta shihnin fatin e tyre, jo të lidhur me *Konstantininë*, kryeqendrën e perandorisë osmane, por me fytyrë nga Perëndimi, dhe ky riorientim i tyre ishte një ndryshim cilësor në mendësi dhe vetënjohje.

Stemë dhe shkrim glagolitik
(ilirik), viti 1726, nën
drejtimin e Vincenz Zmajeviç.



Duke qenë se historia e letërsisë, si çdo histori tjetër, ka si parim themelor renditjen kronografike të fakteve dhe periodizimin e tyre sipas kriteresh kohorë, faktet e reja që kanë dalë në dritë mund të bëjnë të detyrueshëm një periudhizim të ri të saj, që do të përfshinte shekujt ndërmjet letërsisë humaniste dhe asaj romantike, prej Bogdanit tek De Rada, një periudhë e mbushur me fakte të rëndësishme kulturore parësore, ku bashkohen *dukuri iluministe, postiluministe dhe pararomantike*. Hipoteza jonë ka në thelb propozimin që raportet e zhvillimeve shqiptare me iluminizmin francez të shihen me të njëjtin elasticitet si raportet e shkrimeve të para shqipe me Reformën dhe Kundërreformën: letërsi humaniste në gjuhët popullore, por pa dukuri të protestanizmit, pa lëkundje të pozitës kishtare, si në vendet e Europës Qendrore.

Në historiografinë letrare të derisotme është konsideruar se kufiri i fundmë i letërsisë së autorëve më të vjetër, të qarkut katolik verior, është përmbledhja e akteve të *Koncilit të Arbënit* (1703). Madje vepra e Pjetër Bogdanit *Çeta e profetëve* është cilësuar si prekursor e Rilindjes Kombëtare. Në anën tjetër, kronologjikisht, si data më e hershme e kësaj epoke shenjohe *Enciklika* e Naum Veqilharxhit (1845) drejtuar bashkatdhetarëve ortodoksë. Por çfarë ndodh në letërsi ndërmjet viteve 1703-1845? Kjo pyetje lidhet në thelb me nevojën e ripërdizimit të historisë së letërsisë, e cila duhet të jetë analoge me zhvillimin e letërsisë vetë, pa zbrazëti nga një kohë në tjetrën. Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, shekulli i pranisë së murgjve bazilianë në këtë anë të Adriatikut, qindvjetëshi i rritjes së vëmendjes për shqipen, shekulli i arsimit e i arsyes, do të mund të quhej *shekulli i iluminizmit gjuhësor*.

BIBLIOGRAFI

- A. Rëmbeci, *Kodikët mesjetarë në Shqipëri, ura kulturore midis Lindjes dhe Perëndimit: rasti i kodikëve me prejardhje italo-bizantine*, në “Shqipëria mes Lindjes dhe Perëndimit”, botim i Universitetit të Tiranës, shtëpia botuese “Ani-Print”, Tiranë, 2014.
- A. Theiner, *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam illustrantia. A Clemente VII, usque ad Pium VII (1524-1800) cum additamentis saec. XIII et XIV*, volume 2, Zeller 1968 (*Vincentius Zmajevic, archiepiscopus Antibarensis, rogat papam Cleraentem XI ut patru sui Andreae ecclesiasticos annales illyrica lingua exaratos publici iuris faciat, Cathari, 1 septembris 1711*).
- B. Demiraj, *Concili provincialia o Cuvendi j Arbenit*, Botime françeskane, Shkodër 2012.

- B. Demiraj, *Joseph Schirò në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII*, në “Studi filologici arbëreshë”, ediz. “Comet Editor Press”, Cosenza, 2015.
- B. Demiraj, *Si ta lexojmë Lajbnicin*, në “Studime filologjike”, nr. 1-2, 2001.
- E. Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI – Albani dhe Kuvendi i Arbënit*, ndërmarrja botuese “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 1998.
- E. Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë – Papës Clementi XI - Albani*, botimet “Faik Konica”, Prishtinë, 2009.
- E. P. Hamp, *On Leibniz’s Third Albanian Letter*, në “Zeitschrift für Balkanologie”, nr. 16, 1981.
- F. Riceputi, *Prospectus Illyrici sacri cuius historiam describendam typisque mandandam suscipit*, Societatis Jesu Sacerdotes, Patavii MDCCXX.
- F. Altimari, M. Bolognari, P. Carrozza, *L’esilio della parola: la minoranza linguistica albanese in Italia: profili storico-letterari, antropologici e giuridico-istituzionali*, Pisa, 1986.
- F. Altimari, *Urat e Arbërit*, bot. “Naimi”, Tiranë, 2015.
- F. M. da Lecce, *Dittionario italiano-albanese, 1702*, botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip, përgatitur nga Gëzim Gurga, “Botimet françeskane”, Shkodër, 2009.
- F. M. da Lecce, *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese, del padre Francesco Maria da Lecce*, Roma 1716, con licenza de superiori, nella “Stamperia della Seg. Cong. di Prop. Fede”.
- F. Bulić, *Accessiones et correctiones all’Illyricum sacrum del P.D. Farlati, manoscritto inedito pubblicato dal prof. Fr. Bulić*, Supplemento al Bullettino di Archeol. e stor. daim., a. 1902-1910.
- G. Cucco (a cura di), *Papa Albani – Le arti a Urbino e a Roma 1700-1721*, ediz. “Marsilio”, Venezia, 2001.
- G. Stepanić, *Hrvatsko pjesništvo na latinskom u sedamnaestom stoljeću: stilske tendencije i žanrovski inventar*, Doktorska disertacija, Zagreb, 2005.
- G. W. Leibniz, *Opera Philologica*, Hildesheim, 1989.
- H. Morović, *Bilješke uz katalog Riceputijeve “Ilirske biblioteke”*, izd. “Vjesnik bibliotekara Hrvatske”, vol. 9, Zagreb, 1963.
- J. Bulo, *Parathënie*, në *Thimi Mitko, Fjalëtore shqip-gërqisht gërqisht-shqip dhe ndihmesa të tjera leksikografike* (përgatitja e dorëshkrimeve për botim dhe studimi hyrës nga Dhori Q. Qiriazhi), botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2014.
- J. Ljučić, *Daniele Farlati (1690-1773)*, izdan. “Historijski zbornik”, 1972-1972, vol. XXV-XVII, Zagreb, 1974.

- K. Krstić, *Vicko Zmajević*, në “Enciklopedija Jugoslavije”, JLZ, Zagreb, 1971.
- L. Čoralić, *Iz prošlosti Boke – peraški rod Zmajevića*, në “Slobodna Dalmacija”, 8-10 prill 2004 dhe 13-14 prill 2004.
- M. Mandalà, *Ideologjia albaniste dhe rilindja e parë: aktivitetet e arbëreshëve gjatë shekullit XVIII*, në “Një rilindje para Rilindjes”, botim i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2014.
- M. Šamšalović, *Građa za Illyricum Sacrum savučana u Padovi*, ed. Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, izdan. Historijski Institut, Dubrovnik, 1960.
- M. Vanino, *Illyricum sacrum i Filip Riceputi*, izdan. “Croatia sacra”, vol. I, Zagreb, 1931.
- N. M. Frieri, *Il dolente pontificato di Clemente XI (1700 -1721)*, ediz. “Sapere Aude”, Urbino, 1993.
- N. Borgia, *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri – shënime mbi misionet në Himarë: shek. XVI-XVIII*, bot. “Naimi”, Tiranë, 2014.
- N. Bardu, *Eighteenth Century Aromanian Writers: the Enlightenment and the Awakening of National and Balkan Consciousness*, në “Philologica Jassyensia”, an III, nr. 1, 2007.
- O. C. Mandalàri, *Girolamo De Rada, precursore della nuova Albania*, në “Archivio Storiografico dei Reduci di Guerra”, Roma, 1939.
- P. Butorac, *Zmajevići* (ogledi), Zagreb, 1988.
- R. D. Chelaru, *Between coexistence and assimilation: Catholic identity and Islam in the Western Balkans (seventeenth-eighteenth centuries)*, në “Revista istorică”, tom XXIII, nr. 3-4, București 2012, p. 291-324.
- S. Novak (prir.), *Stara bokeljska književnost*, ured. Matica hrvatska, Zagreb, 1996.
- Sh. Sinani, *Çështje të ripërdizimit të historisë së letërsisë shqipe*, në *Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura*, bot. “Naimi”, Tiranë, 2015.
- Sh. Sinani, *Jeronim de Rada dhe një çështje e ripërdizimit të historisë së letërsisë shqipe*, në “Jeronim de Rada, me rastin e 200-vjetorit të lindjes”, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2015.
- Sh. Sinani, *Kodikët kronografikë të Shqipërisë*, bot. “Naimi”, Tiranë, 2014.
- T. Mrkonjić, *Vicko Zmajević*, në “Gli scritti filologici di Giovanni Pastrizio (1636-1708)”, Roma, 1991.
- V. Babić (prir.), *Hrvatska književnost Boke Kotorske do preporoda*, ured. Erasmus naklada, Zagreb, 1998.
- V. Babić, *Razgovor duhovni Vicka Zmajevića*, HKD Napredak, Zadar, 2005.
- V. Zmajević, *Musarum chorus excitatus ad laudes ilustriss. et excellentiss. d. d. Antonii Zeni Venetarum copiarum terra, marique iam inaugurati*

praefecti generalis ab abbate Vincentio Zmaievich Perastino, Collegii Urbani de Propaganda Fide alumno. Romae, Typis Francisci de Rubeis, & Francisci Mariae Acsamitek à Kronenfeld. MDCXCIV.

V. Zmajević, *Notitie universali dello stato di Albania e dell'operato da Monsignor Vincenzo Zmaievich, Arcivescovo di Antivari, Visitatore Apostolico dell'Albania*, në “Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert” (ed. by Peter Bartl), vol. II, Wiesbaden-Munich, 1979.

SUMMARY

FROM THE CENTURY OF LINGUISTIC ENLIGHTENMENT TO THE CENTURY OF LINGUISTIC NATIONALISM

XVIIIth century was not *a century of crisis*, but a historic passage towards the ideology which G. Guzzeta would call *l'albanesità*. The factors that lead to the birth of linguistic enlightenment and the preparation of national ideology are strongly connected with the apostleship of *Pope Clemente XI* as the head of Holy See.

Some of the fundamental initiatives benefiting the language and the history of the people of *Pope Clemente's XI* origin as a direct founder, director and caretaker are:

1. *Italian-albanian dictionary* of Francesco Maria da Lecce.
2. A Grammar of Albanian language by the same author.
3. The project of publishing the most important complete work of the history of Albanians and ProtoAlbanians, that would testify not only their ecclesiastic history, but their laic life, too. This is known by the title *Illyricum Sacrum*.
4. *The Arbëni Meeting* was organized under the direct care of *Pope Clemente XI*.
5. Establishing of removed Kelmendas from their birthplace to Zara of Arbëresh is connected closely with his authority as a Pope.
6. The encouragement of bazilian monks' mission in protection of their compatriots in South Albania, was undertaken under the sovereign care of the Holy See (Apostolic See), in the time of his apostleship.
7. Although it was founded 2 years after the death of *Pope Clemente XI*, the Arbereshi college *Corsini* of San Benedetto in Ullano, known by them as *St. Benethiti: una vera e propria struttura universitaria per la formazione del clero Greco-albanese*, was an initiative projected by him. The foundation of this college turned the XVIIIth century as the century of colleges and workshops, which would be the places where was born the first interest for Albanian language and the origin of Albanian people.
8. In the correspondence with archbishop of Tivari, *Vincenzo*

Zmaievich, Pope Clemente XI, during the pastoral visit in all parts of Arbëni, asked to know whether the Albanian ***people used their own language, the language of arbëresh***. 9. Arbëresh missionaries who came with ecclesiastic duties, decided to use in their writings F. Bardhi's alphabet, because his was the alphabet of the first book in Albanian, officially *confirmatur* (confirmed) from *Fidæ's Propaganda*. 10. The passing from archaonyms and xenonyms of that time of Albanians (*epirot, maqedonas*) to the new ethnonyms (*shqiptar* and *Shqipëri*) was a result of the pontifical care for Albanian language. 11. Albanian National Renaissance had the luxury to find ready not only the fundamental myths of romanticism: the myth of maternal language, the myth of Autochthony, the myth of great period of anti-othoman resistance, the myth of *albanocentrism*, but also the new name of the people and the nation. 12. The main products of linguistic enlightenment of XVIIIth century were mainly dictionaries and grammar books that were addressed to the foreigners who wanted to learn Albanian language. In addition, during this century emerged the period of national literature. Linguistic enlightenment prepared the national ideology, which, first of all, was shown like *linguistic nationalism*, with the cult of maternal language. In the century of linguistic nationalism the Albanian language was used in dictionaries and grammars used for the teaching of Albanian as mother tongue. While this is an essential difference, it is not a Copernican overturn: the Pelasgic myth of the origin of Albanian as the pivot of all the myths of national romanticism was threaded during the period of the linguistic enlightenment.